



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 21

2002

Qershor

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 37, datë 16.5.2002	Për krijimin e Komisionit të Integrimit European dhe Paktit të Stabilitetit 677
Vendim i Kuvendit nr. 38, datë 22.5.2002	Për një ndryshim në përbërjen e Komisionit të Përhershëm për Politikën e Jashtme të Kuvendit..... 678
Vendim i Kuvendit nr. 39, datë 23.5.2002	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 36, datë 16.5.2002 “Për krijimin e Komisionit Parlamentar për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të OSBE- së/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001”..... 678
Vendim i Kuvendit nr. 40, datë 23.5.2002	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 37, datë 16.5.2002 “Për krijimin e Komisionit të Integrimit European dhe Paktit të Stabilitetit” 679
Dekret nr. 3344 datë 24.5.2002	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare 680

Vendim i KM nr. 207, datë 9.5.2002	Për përcaktimin e punëve të vështira ose të rrezikshme.....	681
Vendim i KM nr. 221, datë 16.5.2002	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 231, datë 11.5.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën provës", ndryshuar me vendimin nr.196, datë 6.4.2001 të Këshillit të Ministrave.	683
Vendim i KM nr. 224, datë 24.5.2002	Për afatet e garancisë së produkteve ushqimore	684
Vendim i KM nr. 226, datë 24.5.2002	Për miratimin e fondit të shpenzimeve të vitit 2002 për Entin Rregullator të Telekomunikacioneve	685
Vendim i KM nr. 228, datë 24.5.2002	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 335, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik"	688
Vendim i KM nr. 230, datë 24.5.2002	Për mbylljen tërësore të disa minierave të hekur-nikelit, bakrit e mineraleve të tjera në Librazhd, Mirditë, Pukë, Shkodër, Malësi e Madhe, Tropojë, Korçë, Kukës dhe Tiranë, si dhe për privatizimin e disa njësive të shërbimit të Albkrom sh.a-së.....	689
Udhëzim i KM nr. 1, datë 24.5.2002	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.1, datë 1.1.1996 të Këshillit të Ministrave "Për prokurimin publik"	691
Vendim i GjK nr. 103, datë 23.5.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.173, datë 3.5.2002 të Këshillit të Ministrave "Për lirim dhe emërim në detyrë".....	696
Vendim i GjK nr. 104, datë 24.5.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të ndërmjetëm nr.3447 Akti, datë 12.6.1998 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; të vendimeve nr.1292, datë 17.11.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.1208, datë 12.11.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) dhe nr.L-2, datë 22.10.2001 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.....	697
Vendim i GjK nr. 106, datë 27.5.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 1009, datë 9.11.1999 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	699
Vendim i GjK nr. 109, datë 28.5.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.8, datë 20.4.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe	

	nr.1070, datë 21.10.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; pezullimin e aktit nr.219, datë 25.1.2002 të Zyrës së Përmbarimit Tiranë për ekzekutimin e vendimeve të mësipërme.....	701
		
Vendim i GjK nr.110, datë 28.5.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr. 2794, datë 5.10.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.330, datë 6.4.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.220, datë 19.3.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	703
	<i>Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Shyqyri Matopalaj</i>	705

V E N D I M
Nr. 37, datë 16.5.2002

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PAKTIT TË STABILITETIT

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të neneve 22, 30 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Përhershëm për Politikën e Jashtme të Kuvendit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Krijohet Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Integrimin European dhe Paktin e Stabilitetit, në përputhje me detyrimet që lindin nga zbatimi i procesit të integrimit european dhe Paktit të Stabilitetit dhe, në veçanti, nga hapja e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit.

II. Komisioni ndërtohet sipas propozimit të Komisionit të Përhershëm për Politikën e Jashtme, në përbërje të të cilit do të përfshihen edhe përfaqësues të komisioneve të tjera të përhershme të Kuvendit, si Komisioni i Përhershëm për Politikën e Jashtme, Komisioni i Përhershëm për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore, Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financat dhe Privatizimin, Komisioni i Përhershëm i Rendit dhe SHISH-it, Komisioni i Përhershëm për të Drejtat e Njeriut dhe Minoritetet, si dhe Komisioni i Përhershëm i Mbrojtjes. Ky Komision do të veprojë në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

III. Qëllimet kryesore të këtij Komisioni janë:

1. Nxitja e procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin European dhe zbatimi i Paktit të Stabilitetit si instrument që e afron vendin tonë me Europën.

2. Bashkërendimi ndërparlamentar i komisioneve të përhershme të Kuvendit për synimet e këtij Komisioni.

3. Koordinimi i politikave të Kuvendit, Këshillit të Ministrave dhe institucioneve të tjera të lidhura me Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit dhe Paktin e Stabilitetit.

4. Përputhja e legjislacionit shqiptar me standardet dhe kërkesat e Bashkimit European.

5. Forcimi i bashkëpunimit midis Kuvendit të Shqipërisë, Parlamentit European, asambleve parlamentare të KE-së dhe OSBE-së, për të ndikuar në nxitjen e zbatimit të Paktit të Stabilitetit dhe përshpejtimin e procesit të stabilizim-asocimit.

6. Krijimi i bërthamave parlamentare për parandalimin e konflikteve në rajon dhe shkëmbimin e informacioneve ndërmjet parlamenteve.

7. Forcimi i bashkëpunimit me parlamentet e rajonit, shkëmbimi i përvojave në procesin e stabilizim-asocimit.

8. Plotësimin e kushteve dhe detyrimeve për hapjen e negociatave të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit në fushën politike, ekonomike, të drejtësisë dhe mjedisit.

9. Transparenca ndaj opinionit publik, si dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile në zbatimin e procesit të integrimit european dhe Paktit të Stabilitetit.

10. Organizimi i rregullt i debateve parlamentare për rëndësinë e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikut njerëzor, me qëllim mbajtjen e këtij problemi vazhdimisht në axhendat politike kombëtare.

11. Informimi i Kuvendit me politikat e demokracisë, sigurisë e të zhvillimit ekonomik në kuadër të Paktit të Stabilitetit dhe iniciativave të tjera rajonale, si SEECEI, SEECP, Adriatiko-Joniane etj.

IV. Afati i veprimtarisë së Komisionit përcaktohet në përputhje me zhvillimet dhe nevojat e proceseve të lartpërmendura.

V. Komisioni çdo 45 ditë njofton Kuvendin për punën e tij.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr. 38, datë 22.5.2002

**PËR NJË NDRYSHIM NË PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR
POLITIKËN E JASHTME TË KUVENDIT**

Në mbështetje të neneve 24, 27 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Përbërja e Komisionit të Përhershëm për Politikën e Jashtme të ndryshohet nga 11 anëtarë në 13 anëtarë.

II. Në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Politikën e Jashtme të bëjnë pjesë deputetët Namik Dokle dhe Ridvan Bode.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr. 39, datë 23.5.2002

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.36, DATË 16.5.2002 “PËR KRIJIMIN E
KOMISIONIT PARLAMENTAR PËR SHQYRTIMIN DHE ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE TË OSBE-SË/ODIHR-IT PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË
VITIT 2001”**

Në mbështetje të neneve 22, 30 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 36, datë 16.5.2002 “ Për krijimin e Komisionit Parlamentar për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të OSBE-së/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001”, pas pikës III shtohet pika si më poshtë:

“III/I. Përbërja e Komisionit Parlamentar Bipartizan është si më poshtë:

1. Bashkim Fino PS
2. Ylli Bufi PS
3. Taulant Dedja PS
4. Blendi Klosi PS
5. Gaqo Apostoli PSD
6. Ligoraq Karamelo PBDNJ

- | | |
|-----------------------|-------------------|
| 7. Ndue Preka | PA |
| 8. Preç Zogaj | PAD |
| 9. Nikollë Lesi | Deputet i pavarur |
| 10. Nard Ndoka | PDR |
| 11. Jemin Gjana | PD |
| 12. Sokol Olldashi | PD |
| 13. Aleksandër Garuli | PR |
| 14. Sadedin Balla | PLL |
| 15. Alfred Çako | PBK |
| 16. Teodor Laço | PBL”. |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr. 40, datë 23.5.2002

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 37, DATË 16.5.2002
“PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT EUROPIAN
DHE PAKTIT TË STABILITETIT”

Në mbështetje të neneve 22, 30 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 37, datë 16.5.2002 “Për krijimin e Komisionit të Integrimit dhe Paktit të Stabilitetit”, pas pikës III shtohet pika si më poshtë:

“III/I. Numri dhe përbërja e Komisionit të jetë si më poshtë:

1. Ilir Gjoni PS
2. Petro Koçi PS
3. Arben Malaj PS
4. Taulant Dedja PS
5. Paskal Milo PSD
6. Vangjel Dule PBDNJ
7. Vladimir Malo PA
8. Neritan Ceka PAD
9. Qazim Tepshi PDR
10. Lublin Dilja PD
11. Fatmir Mediu PR
12. Arjan Starova PBL
13. Eqerem Spahia PLL
14. Uran Metko PBK”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
Servet Pëllumbi

D E K R E T
Nr. 3344, datë 24.5.2002

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Genit Bardhul Shtylla
2. Teuta Hamid Höfs (Idrizi)
3. Anila Xhemal Gottschling (Çiba)
4. Migena Aleksandër Dhima
5. Lindita Simon Hofmann (Rica)
6. Sokol Bashkim Kerxhaliu
7. Flora Riza Lindner (Feza)
8. Mendu Skënder Guza
9. Shpetim (Shpëtim) Naim Jaupi
10. Spartak Bujar Skenderi
11. Arben Lajmer Muhamete
12. Franky Arben Muhamete
13. Albana Mark Muhamete (Mici)
14. Arben Shaban Arifi
15. Lisiena Arben Arifi
16. Anjes Arben Arifi
17. Armilda Osman Arifi (Tafa)
18. Flamur Hamit Gjika
19. Alma Kame Iseni (Godolja)
20. Franz Ahmet Gori
21. Franciska Ahmet Gori
22. Achmet Ahmet Gori
23. Franc Kin Pavaci
24. Rajmonda Rrok Pavaci (Sokoli)
25. Jakobin Franc Pavaci
26. Meri Franc Pavaci

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr. 207, datë 9.5.2002

PËR PËRCAKTIMIN E PUNËVE TË VËSHTIRA OSE TË RREZIKSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 100 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.3.1996, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e punëve të vështira ose të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njeriut, si më poshtë vijon:

- a) Punët në miniera, në nëntokë, dhe në punimet e tjera, në nëntokë, që kryhen nga:
 - minatori, armatori, zjarrmëtari dhe ndihmësit e tyre;
 - drejtuesi teknik (personeli inxhiniero-teknik);
 - punëtori i transportit dhe i ngarkimit;
 - punëtori i shërbimit të ajrimit dhe ai elektromekanik;
 - personeli shpëtues dhe inspektues, në miniera, dhe personeli i repartit të inspektim-shpëtimit, miniera, Tiranë.
- b) Punët në aviacionin civil, që kryhen nga:
 - komandanti i avionit,
 - piloti,
 - navigatori,
 - mekaniku,
 - radiotelegrafisti,
 - radiotelefonisti.
- c) Punët në fabrikat e pasurimit të minierave të bakrit, kromit, qymyrgurit, në fonderitë dhe në impiantin e pasurimit të rërave bregdetare dhe në fabrikat e pasurimit të kuarcit, ku përfshihen:
 - punët në fonderi;
 - punët në farkëtarë;
 - punët në kaldaja dhe në enët nën trynë;
 - saldimit me hark elektrik dhe puna e operatorëve të automatëve të saldimit;
 - saldimit me oksiacetilen.
- ç) Punët e tilla të:
 - polumbarit;
 - saldatorit, elektrosaldatorit në rezervuare, kulla dhe cisterna;
 - punonjësit të pastrimit të brendshëm të rezervuarëve;
 - punonjësit që punon me solucione aerosole, radioaktive;
 - punonjësit që punon me rreze radioaktive dhe në mjedise radioaktive;
 - makinistit dhe ndihmësmakinistit.
- d) Punët në fushat e arsimit dhe të kulturës, si ato të:
 - balerinit dhe valltarit të ansambleve;
 - akrobatit dhe gjimnastit të cirkut;
 - solistit të operas;
 - muzikantit të veglave frymore, të orkestrave dhe të bandave.
- dh) Punët në fushën e shëndetësisë:
 - me rrezatime jonizuese (kobaltoterapia, imazheria, radiotologjia klasike, skaneri, rezonanca magnetike);
 - në laboratorët mikrobike;
 - në shërbimin infektiv, në kirurgji dhe anestezi në sallat e operacionit me gazra.
- e) Punët në industrinë e bakrit.
- ë) Punët në industrinë kimike dhe atë përpunuese si:
 - në prodhimin e baterive;
 - në përpunimin e lëkurëve dhe të peliçeve;
 - në fabrikat e letrës.
- f) Punët në industrinë metalurgjike, të naftës dhe prodhimit të nënprodukteve të saj, si:
 - në metalurgjinë e zezë të ferrokromit;

- në uzinat e petëzimit;
 - në uzinat e gizës;
 - në repartet e furnaltës;
 - në prodhimin e substancave sintetike, polisterolit, polietilenit etj.
- g) Punët në industrinë elektrike:
- në lartësi mbi 5 metra nga sipërfaqja e tokës;
 - në shërbimet operative, në nënstacionet 110 kv e lartë;
 - në shërbimet e pajisjeve, që lëshojnë rreze monokromatike koherente (rreze lazer), rreze elektromagnetike, me frekuencë të lartë, shumë të lartë, të ulët dhe shumë të ulët;
 - në shërbimet me elektrovinça, me kulla të lëvizshme;
 - në shërbimet operative në filialet elektrike, shpërndarëse.
- gj) Punët në prodhimin e tullave e të tjegullave dhe të artikujve prej qeramike, si:
- në prodhimin e çimentos;
 - në prodhimin e xhamit, qelqit dhe të llampave elektrike;
 - në industrinë e lëkurëve;
 - në industrinë e drurit, të letrës dhe të pllakave të zdrukthit.
- h) Punët në industrinë e fermentimit të duhanit dhe në industrinë e prodhimit të cigareve.
- i) Punët në ndërtim të:
- punëtorit të asfaltit dhe të punëtorit të prodhimit të asfaltit;
 - punëtorit që përgatit betonin;
 - punëtorit që ngre oxhaqe industriale;
 - punëtorit që monton shtyllat e tensionit të lartë;
 - sondistit;
 - eskavatoristit;
 - minatorit në gurore;
 - rulistit;
 - minatorit në karrierat e argjilave;
 - punëtorit të poligrafisë.
- j) Punët në ndërmarrjet ushtarake:
- në çmontimin e municioneve;
 - në nxjerrjen e eksplozivit nga predhat e çmontuara;
 - në nxjerrjen e barutit nga gëzhhojat e municioneve të çmontuara;
 - në transportimin e municioneve, baruteve dhe eksplozivëve;
 - në manipulimin e enëve nën presion;
 - në poligonet e provave të fishekëve dhe shtimjeve;
 - në prodhimin dhe baterive të thata (përgatitja e elektrolitit dhe përzierja e aglomeratit);
 - në linjat e prodhimit në tunel;
 - në proceset galvanike;
 - në prodhimin e fishekzjarrëve;
 - në prodhimin e gomave (përgatitja e brumit);
 - në saldimet me kallaj;
 - në proceset e pastrimit me rërë dhe shkëlqim detalesh;
 - në prodhimin e kapsollave;
 - në linjat e përpunimit dhe prodhimit të baruteve dhe eksplozivëve;
 - në prodhimin dhe manipulimin e lëndëve shpërthyesë, iniciale, barute, eksplozive.
2. Punëdhënësit janë të detyruar të marrin në këto punë punëmarrës, të pajisur me dëshmi profesionale dhe me certifikatën e aftësisë mjekësore.
3. Punëdhënësit dhe punëmarrësit, me marrëveshje dypalëshe, parashikojnë kushtet e përshtatshme për këto vende pune, përherë në mbrojtje të shëndetit dhe të personalitetit të punëmarrësve.
4. Punëdhënësit janë të detyruar të krijojnë kushte të larta sigurie dhe higjienë në këto vende pune.
5. Ngarkohen ministrinë përkatëse të nxjerrin udhëzimet për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e këtyre punëmarrësve, në fushat e veprimtarisë që mbulojnë.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr. 221, datë 16.5.2002

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 231, DATË 11.5.2000 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL DHE
PERIUdhËN E PROVËS", NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.196, DATË 6.4.2001 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 231, datë 11.5.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës", ndryshuar me vendimin nr.196, datë 6.4.2001 të Këshillit të Ministrave bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Shkronja "b" e pikës 11 ndryshon si më poshtë vijon:

"b) Dy pedagogë nga fakulteti, sipas fushës ku do të zhvillohet testimi, të përcaktuar nga dekanati përkatës apo dy specialistë të njohur në fushën përkatëse, të përcaktuar nga fakultetet apo institucionet e tjera, arsimore-shkencore, sipas kërkesës dhe kriterëve të Departamentit të Administratës Publike për institucionet qendrore dhe të departamentit, drejtorisë, seksionit apo zyrës së personelit për institucionet e pavarura."

2. Pika 14 ndryshon si më poshtë vijon:

"14. Personat e përcaktuar në shkronjën "b" të pikës 11 të këtij vendimi shpërblehen në masën 6 500 (gjashtë mijë e pesëqind) lekë për çdo ditë angazhimi në testime. Të gjitha shpenzimet përballohen nga buxheti i institucionit për të cilin zhvillohet konkurrimi."

3. Pika 18 ndryshon si më poshtë vijon:

"18. Menjëherë pas nxjerrjes së rezultateve nga komiteti ad-hoc, kryetari shpall listën me renditjen e kandidatëve dhe shumën e pikëve të testimit për çdo kandidat, në një vend të dukshëm, të caktuar, në ndërtesën ku është zhvilluar testimi dhe në buletin e Departamentit të Administratës Publike."

4. Pika 19 ndryshon si më poshtë vijon:

"19. Eprorit direkt i paraqiten tre kandidatët me rezultatet më të mira nga Departamenti i Administratës Publike për institucionet e administratës qendrore dhe nga departamenti, drejtoria, seksioni apo zyrat e personelit për institucionet e pavarura. Eprori direkt zgjedh njërin prej tyre pas një bashkëbisedimi me secilin nga të tre kandidatët e propozuar. Eprori direkt mund të kërkojë përsëritjen e procedurës së pranimit kur asnjëri nga kandidatët nuk ka marrë mbi 50 pikë. Në çdo rast, vendimi i eprorit direkt duhet të jetë i motivuar dhe i bazuar në parimet e barazisë, mirëbesimit dhe mosdiskriminimit. Vendimi i eprorit direkt jepet pas verifikimit të vërtetësisë së dokumenteve, në mbështetje të të cilave është kryer procesi i konkurimit."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR AFATET E GARANCISË SË PRODUKTEVE USHQIMORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, 24 dhe 41 të ligjit nr.7941, datë 31.5.1995 "Për ushqimin", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Prodhuesit, importuesit, magazinuesit dhe shitësit e produkteve ushqimore, sigurojnë afatin e garancisë dhe kushtet e ruajtjes. Për personat juridikë, vendas dhe të huaj, lejohet prodhimi dhe importimi i produkteve ushqimore, të kategorisë "Ushqime që prishen shpejt", me afat garancie jo më pak se 1/3 e kohës së deklaruar të përdorimit të tyre, ndërsa produktet ushqimore me afat përdorimi të gjatë lejohen të importohen brenda jo më pak se 6 muajve të fundit të afatit të garancisë.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministria e Shëndetësisë të nxjerrin udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M Nr. 226, datë 24.5.2002

PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË VITIT 2002 PËR ENTIN RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të dytë të nenit 87 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të vitit 2002 për Entin Rregullator të Telekomunikacioneve, në shumën 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, sipas shtojcës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit të Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

SHTOJCA STRUKTURA E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE PËR VITIN 2002

Nr.	Emërtimi	Shuma në lekë
	Shpenzime gjithsej	65 000 000
1.	Shpenzime për paga	11 995 000
2.	Shpenzime për sigurime shoqërore	2 309 000
3.	Shpenzime për materiale e shërbime	10 696 000
4.	Shpenzime për investime	40 000 000

Enti rregullator i telekomunikacioneve
P/Plani financiar
Viti 2002
Shqyrtuar nga Këshilli Drejtues i ERT,

Nr. _____ Prot.
Tiranë, më _____
Miratuar nga Këshilli i Ministrave
Vendim nr. _____ datë _____
Enti rregullator i telekomunikacioneve
Drejtoria Ekonomike dhe E Administrimit

PASQYRË PËRMBLEDHËSE E ARKËTIMEVE DHE SHPENZIMEVE

000/Lekë

Nr.	Emërtimi	Vjetori	Ndarë në tremujorë			
			I	II	III	IV
1	Arkëtime gjithsej	65 000	61 800	1 700	1 050	450
2	Shpenzime gjithsej	65 000	46 699	6 299	6 099	5 903

Enti rregullator i telekomunikacioneve
Drejtoria Ekonomike dhe E Administrimit

PLANI I ARKËTIMEVE

000/Lekë

Nr.	Emërtimi	Vjetori	Ndarë në tremujorë			
			I	II	III	IV
	Arkëtime gjithsej	65 000	61 800	1 700	1 050	450
a	Nga operatorë publikë	52 000	52 000	0	0	0
b	Nga operatorë në zonat rurale	1 000	800	100	100	0
c	Nga shërbimet private të radiokom	5 000	4 000	500	300	200
d	Nga shërbimet satelitore	500	400	100	0	0
e	Nga shërbimi internet (ISP)	1 500	1 000	300	200	0
f	Nga ofrues shërbimi	200	100	50	50	0
g	Nga shërbime të ndryshme	200	100	50	50	0
h	Nga numeracioni	300	200	50	50	0
j	Nga funksioni agjent tatimor	4 000	3 000	500	250	250
k	Nga të ardhurat financiare	300	200	50	50	0

Enti rregullator i telekomunikacioneve
Drejtoria Ekonomike dhe E Administrimit
Pasqyrë përmbledhëse e shpenzimeve

000/Lekë

Nr	Emërtimi	Vjetori	Ndarë në tremujorë			
			I	II	III	IV
	Shpenzime gjithsej	65 000	46 699	6 299	6 099	5 903
a	Shpenzime për paga	11 995	2 998	2 998	2 998	3 001
b	Shpenzime për sigurime shoqërore	2 309	577	577	577	578
c	Shpenzime për materiale dhe shërbime	10 696	3 124	2 724	2 524	2 324
d	Shpenzime për investime	40 000	40 000	0	0	0

Enti rregullator i telekomunikacioneve
Drejtoria Ekonomike dhe E Administrimit
Numri i punonjësve dhe fondi i pagave

000/Lekë

Nr.	Kategoritë	Nr.mesatar vjetor i punonjësve	Paga mesatare	Fondi i pagave	Shpërblime plotësuese	Fond page rezervë	Sigurime shoqërore 34.20%	Sigurime shoqërore 11.70%	Tatim mbi të ardhurat
	Nr. punonjësve	25	38 112	9 258	1 542	925	2 309	612	616

	gjithsej								
a	Këshilli Drejtues	5	60 368	3 622	604	362	517	177	376
b	Specialistë	11	28 672	3 785	630	378	1 137	389	214
c	Nëpunës	3	18 866	680	113	68	232	79	16
d	Punëtorë	6	16 270	1 171	195	117	423	141	10

Enti rregullator i telekomunikacioneve
Drejtoria Ekonomike dhe E Administrimit
Plani i investimeve

000/Lekë

Nr.	Emërtimi	Vjetori	Ndarë në tremujorë			
			I	II	III	IV
	Investime gjithsej	40 000	40 000			
a	Qendër monitorimi, faza e dytë	40 000	40 000			

V E N D I M

Nr. 228, datë 24.5.2002

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 335, DATË 23.6.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.335, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik" të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Shkronja "a" e pikës 1 ndryshon si më poshtë vijon:

"a) Enti prokurues të përdorë procedurën e prokurimit "Tender i hapur", në përputhje me nenin 23 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", kur vlera e përlogaritur e kontratës është mbi 5 (pesë) milionë lekë për prokurimin e ndërtimeve, mbi 3 (tre) milionë lekë për prokurimin e mallrave dhe mbi 1 (një) milionë lekë për prokurimin e shërbimeve, me përjashtim të projekteve, ku si referim të merret vlera e parashikuar për sipërmarrjen e ndërtimit të objektit dhe jo ajo e shërbimit.

Enti prokurues të përdorë procedurën "Tender i hapur ndërkombëtar", kur vlera e përlogaritur e kontratës është mbi 300 (treqind) milionë lekë."

2. Në pikën 2 fjala "projekteve" zëvendësohet me "projekteve".

3. Në pikën 4 të bëhen këto ndryshime:

Shkronja "a" ndryshon si më poshtë vijon:

"a) Pika 1/b/c/ç, për vlerë jo më të madhe se 30 për qind e kontratës fillestare, kur nevoja për këtë shtesë del gjatë kohës së realizimit të kontratës, deri në 3 muaj pas përfundimit të saj."

- Fjalja e parë e shkronjës "b" ndryshon si më poshtë vijon:

"b) Për prokurimet me vlerë të vogël, kur vlera e përlogaritur e prokurimit për çdo artikull ose zë nuk është më e madhe se 300 (treqind) mijë lekë brenda një vitit kalendarik. Me artikull, në kuptim të këtij vendimi, do të kuptohet një grup mallrash, që kanë të njëjtin emër dhe funksion kryesor."

- Pas shkronjës "c" shtohet shkronja "ç", me këtë përmbajtje:

"ç. Entet prokuruese, për plotësimin e nevojave të fillimit të çdo viti, lejohen të lidhin kontrata shtesë me kontraktuesit e tyre të fundit për mallrat apo shërbimet. Kjo kontratë shtesë do të jetë e vlefshme vetëm për periudhën deri në datën e nënshkrimit të kontratave, për fondet e vëna në

dispozicion."

4. Në pikën 7 bëhen këto ndryshime:

Shkronja "a" dhe "b" ndryshojnë si më poshtë vijon:

"a) te titullari i entit prokurues për të gjitha prokurimet me vlerë jo më të madhe se 5 (pesë) milionë lekë.

b) te titullari i organit, qendror ose vendor, për prokurimet me vlerë mbi 5 (pesë) milionë lekë, por jo më të madhe se 100 (njëqind) milionë lekë."

5. Fjalja e parë e pikës 10 ndryshon si më poshtë vijon:

"10. Të gjitha entet prokuruese të dërgojnë për botim në Agjencinë e Prokurimit Publik ftesën për ofertë për "Tender i hapur", "Tender i kufizuar" dhe "Kërkesë për kuotim", jo më vonë se 10 ditë përpara shpalljes së saj, me përjashtim të rasteve të përdorimit të procedurës së prokurimit, sipas pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik..."."

6. Pika 11 ndryshon si më poshtë vijon:

"11. Entet prokuruese, brenda datës 30 janar, të paraqesin në Agjencinë e Prokurimit Publik statistika të sakta për planifikimin vjetor të prokurimeve. Gjithashtu, të paraqesin pranë Agjencisë së Prokurimit Publik edhe ndryshimet e planit të prokurimeve publike gjatë vitit kalendarik. Entet prokuruese, në fund të çdo 4-mujori, brenda datës 20 të muajit pasardhës të paraqesin në Agjencinë e Prokurimit Publik një tregues për realizimin apo jo të prokurimeve të planifikuara, të shoqëruar me relacionin shpjegues. Për realizimin e kësaj detyre, titullari i entit prokurues ngarkon njësinë e prokurimit (nëse ka) apo strukturën përgjegjëse, që planifikon fondet e prokurimeve të entit. Agjencia e Prokurimit Publik, nga ana e vet, brenda datës 30 të po atij muaji duhet të paraqesë në Këshillin e Ministrave një pasqyrë përmbledhëse të prokurimeve në shkallë vendi."

7. Pika 12 ndryshon si më poshtë vijon:

"12. Për një veprim apo mosveprim të kryer nga një ent prokurues, të cilin një kandidat e vlerëson si shkelje të ligjit ose të rregullave të prokurimit, ai është i lirë të bëjë shqyrtim administrativ brenda këtyre afateve:

a) në entin prokurues brenda 5 (pesë) ditëve pas shpalljes së klasifikimit përfundimtar të ofertave;

b) në organin, qendror apo vendor, i cili vë në dispozicion fondin, brenda 5 (pesë) ditëve pas mbarimit të afatit të ankesës pranë entit prokurues; Organi, qendror apo vendor, është i detyruar të kthejë përgjigje brenda 10 ditëve nga marrja e ankesës.

c) në Agjencinë e Prokurimit Publik brenda 5 (pesë) ditëve pas marrjes së përgjigjes nga organi, qendror apo vendor, që vë në dispozicion fondin."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VE N D I M Nr. 230, datë 24.5.2002

PËR MBYLLJEN TËRËSORE TË DISA MINIERAVE TË HEKUR-NIKELIT, BAKRIT E MINERALEVE TË TJERA NË LIBRAZHD, MIRDITË, PUKË, SHKODËR, MALËSI E MADHE, TROPOJË, KORÇË, KUKËS DHE TIRANË, SI DHE PËR PRIVATIZIMIN E DISA NJËSIVE TË SHËRBIMIT TË ALBKROM SH.A. -SË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", ndryshuar me ligjin nr.8582, datë 23.2.2000, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VE N D O S I:

1. Të mos konsiderohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë dhe t'u nënshtrohen procesit të mbylljes, privatizimit ose likuidimit minierat:

- Miniera e hekur-nikelit, SkroskëLibrazhd
- Miniera e hekur-nikelit, XixillasLibrazhd
- Miniera e bakrit, Perlati jugorMirditë
- Miniera e pasurimit të bakrit, RrëshenMirditë
- Miniera e bakrit, Kurbnesi veriorMirditë
- Miniera e vjetër e bakrit, RubikMirditë
- Miniera e bakrit, KabashPukë
- Miniera e bakrit, PalajShkodër
- Miniera e magnezitëve, GomsiqeShkodër
- Miniera e silicit, VilëzShkodër
- Miniera e kuarciteve, GjazujMirditë
- Miniera e argjilave të bardha, Tamarë,Malësia e Madhe
- Miniera e xhamit vullkanik, LumbardhëPukë
- Miniera e kuarciteve, KërnajëTropojë
- Miniera e talkut, ZemblakKorçë
- Miniera e kuarciteve KallabakKukës
- Miniera e boksideve, DajtTiranë
- Parku i transportit të mineraleve Bulqizë
- Njësia e mesatarizimit, LaçKurbin
- Njësia e eksport-importitDurrës

2. Ministria e Industrisë dhe Energjetikës, të fillojë, brenda muajit qershor 2002, procedurat e privatizimit dhe të hartojë projektet për minierat që do të mbyllen. Mbyllja e tyre të përfundojë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2003.

Gjatë procesit të privatizimit të kryhet edhe likuidimi i detyrimeve të prapambetura të sigurimeve shoqërore, të energjisë elektrike ndaj KESH sh.a.-së dhe të detyrimeve ndaj ndërmarrjeve të ujësjellësve.

3. Makineritë, pajisjet, materialet dhe objektet sipërfaqësore të privatizohen, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ose të transferohen për t'u përdorur për nevoja të organeve të pushtetit vendor.

4. Fondet që nevojiten për mbylljen e minierave sipas pikës 1 të këtij vendimi të përballohen nga fondet buxhetore, miratuar për vitin 2002, zëri "Për mbylljen dhe konservimin e objekteve minerare" për Ministrinë e Industrisë dhe Energjetikës.

5. Punonjësit, që dalin të tepër, si pasojë e mbylljes dhe privatizimit të këtyre sektorëve, të cilët kanë filluar punë në këta sektorë para datës 1.5.2001, të trajtohen për 1 (një) vit me pagën mujore, minimale, në shkallë vendi, prej 7580 (shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekësh. Periudha 1 (një)-vjeçare t'u njihet vjetërsi pune për efekt pensioni dhe të shënohet si e tillë në librezë.

6. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë ata punonjës që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike në fushën e punësimit apo të vetëpunësimit, apo që nuk përfitojnë nga procesi i privatizimit. Në rast të kundërt, u ndërpritet trajtimi që përfitojnë sipas këtij vendimi.

7. Fondi prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh në muaj (32 000 000 milionë lekë për vitin 2002) për 360 punonjësit që humbasin vendin e punës nga mbyllja dhe privatizimi i minierave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondet buxhetore të vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

8. Dhënia e pagës punonjësve dhe pagesa e kontributeve për sigurimet shoqërore të bëhen nga zyrat e punës, në njësitet administrative përkatëse.

9. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrin udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

U D H Ë Z I M
Nr. 1, datë 24.5.2002

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 1.1.1996 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PROKURIMIN PUBLIK"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

Në udhëzimin nr.1, datë 1.1.1996 të Këshillit të Ministrave "Për prokurimin publik" të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

KAPITULLI I

Pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4, si më poshtë vijon:

"3. Përcaktimi i fondit limit të bëhet në bazë të çmimeve të publikuara nga INSTAT-i dhe institucionet e tjera shtetërore, përkatëse. Për çmimet e papublikuara, përcaktimi i fondit limit të bëhet në bazë të përvojës së mëparshme të entit prokurues ose sipas testimi të tregut.

Në qoftë se këto të dhëna nuk sigurohen nga burimet e mësipërme, enti prokurues mund të përdorë publikimet ndërkombëtare.

4. Në rastin kur objekti i prokurimit është i ndarë në artikuj apo grup artikujsh, për secilin prej tyre të përcaktohen fondi limit, kur enti prokurues kërkon të shpallë më shumë se një fitues."

KAPITULLI II

Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Procedura e prokurimit vendoset në mbështetje të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik" dhe sipas rregullave të prokurimit publik, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave."

Në pikën 2 shkonja "a" "Procedura e tenderave të hapur dhe ndërkombëtarë", paragrafi i fundit ndryshon si më poshtë vijon:

"Kjo procedurë do të përdoret gjithnjë, kur me anë të saj mund të arrihet një konkurrencë e frytshme, sipas kufijve monetarë të dhëna në rregullat e prokurimit publik, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Në rast të kundër, do të kalohet në procedurat ndërkombëtare, sipas nenit 41 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik."

Në pikën 2 shkonja "c" "Tenderi me dy faza", fjalia e parë e paragrafit të fundit ndryshon si më poshtë vijon:

"Faza e parë e tenderit" me dy faza mund të bëhet e hapur ose e kufizuar, në mbështetje të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik" dhe sipas rregullave të prokurimit publik, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, duke respektuar kufijtë monetarë dhe afatet kohore të dhëna në vendim."

Në pikën 2 shkonja "d" "Kërkesë për kuotim", paragrafi i tretë ndryshon si më poshtë vijon:

"Për sipërmarrjet e ndërtimit dhe shërbimet kërkohet vetëm dokumentacioni ligjor dhe administrativ, kurse për blerjet kushtet e ofertës do të përfshihen në një porosi blerjeje dhe kuotimet mund të pranohen edhe me fax ose me postë elektronike. Dokumentacioni ligjor dhe administrativ do t'i kërkohet vetëm shoqërisë fituese, para lidhjes së kontratës."

Në pikën 2, pas shkronjës "d" të shtohet shkronja "dh", me këtë përmbajtje:

"dh) Prokurimi i drejtpërdrejtë

Kur enti prokurues përdor procedurën "Prokurimmi drejtpërdrejtë", hyn në marrëdhënie dhe kërkon propozim nga një kandidat, si dhe negocion për kushtet e kontratës. Prokurimi i drejtpërdrejtë nuk duhet të përdoret, në asnjë rast, për të mënjnauar konkurrencën e mundshme apo për të diskriminuar kandidatët.

Enti prokurues duhet të përgatisë për këtë procedurë një përshkrim të shkurtër të nevojave dhe kërkesave të veçanta, si p.sh. për cilësinë, sasinë, kushtet dhe afatet e livrimit dhe më pas të negociojë me kandidatin e vetëm."

KAPITULLI III

Në shkronjën "a" "Pjesa e përgjithshme", në formularë që i bashkëlidhen këtij udhëzimi do të përfshihen edhe formularët për:

- "- të dhënat e ofertës,
- sigurimin e kontratës,
- njoftimin e fituesit."

Në nëndarjen me emërtimin "Udhëzime për pjesëmarrësit në tender" të shkronjës "a" "Pjesa e përgjithshme", paragrafi i dytë ndryshon si më poshtë vijon:

"Pjesëmarrësit në tender do të përdorin dokumentet standarde të tenderit dhe kushtet e përgjithshme të kontratës pa bërë ndryshime. Ndryshimet do të bëhen vetëm nëpërmjet të dhënave të ofertës dhe kushteve të veçanta të kontratës."

Nëndarjet me emërtimet "Kërkesat për kualifikim" dhe "Formulari i sigurimit të ofertës" shkronja "a" "Pjesa e përgjithshme" ndryshojnë si më poshtë vijon:

"Kërkesat për kualifikim duhet të përmbajnë dokumentacionin ligjor dhe administrativ të kandidatit, të cilat enti prokurues i vlerëson të nevojshme për realizimin e kontratës, në përputhje me nenin 12 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik". Për sipërmarrjet dhe projektimet në kërkesat për kualifikim do të bëjnë pjesë, përveç dokumentacionit ligjor dhe administrativ, edhe të dhëna të tjera për personelin, aftësitë teknike dhe përvojën e shoqërisë."

"Formulari i sigurimit të ofertës shërben për të mbrojtur entin prokurues nga ofertat e papërgjegjshme. Formulari i sigurimit të ofertës do të ketë formën e një depozite a garancie, të lëshuara nga një bankë ose nga shoqëritë e licencuara nga shteti për këtë qëllim. Sigurimi i ofertës për pjesëmarrësit në tender, që skualifikohen për mosplotësim të dokumentacionit ligjor, u çngurtësohet menjëherë ofertuesve të pasuksesshëm. Kandidatëve të tjerë, të kualifikuar për fazën e shqyrtimit të ofertës tekniko-ekonomike, ky sigurim u kthehet pas lidhjes së kontratës.

Enti prokurues do të përcaktojë përqindjen e sigurimit të ofertës në varësi të vlerës së fondit limit, sipas rregullave të prokurimit publik, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, duke synuar kufirin minimal për kontratat me vlerë të madhe dhe kufirin maksimal për kontratat me vlerë të vogël."

Në shkronjën "b" "Pjesa e veçantë", paragrafi i parë i pikës 1 "Për prokurimin e ndërtimeve" ndryshon si më poshtë vijon:

"Për sipërmarrjet e ndërtimeve, projekti duhet të jetë i përfunduar në fazën e projektzbatimit të hollësishëm, në mënyrë që zërat dhe vëllimet e punës të jenë të përcaktuara mirë në dokumentet e tenderit."

Në shkronjën "b" "Pjesa e veçantë" paragrafi i gjashtë i pikës 1 "Për prokurimin e ndërtimeve" ndryshon si më poshtë vijon:

"Nëse sipërmarrësi plotëson këto kërkesa për kualifikim në masën e dhënë në dokumentet e tenderit, kualifikohet dhe pastaj vlerësohet për çmimin (dhe afatin, në qoftë se ky është parashikuar si kriter vlerësimi në dokumentet e tenderit), që paraqet në ofertën ekonomike, ku si çmim do të merret vlera e plotë e preventivit."

Në shkronjën b "Pjesa e veçantë" paragrafi i dhjetë i pikës 1 "Për prokurimin e ndërtimeve" ndryshon si më poshtë vijon:

"Për kriteret vlerësuese duhet dhënë pesha e secilit kriter d.m.th. pikët maksimale që merr konkurruesi me vlerën më të ulët ose pikët maksimale që merr konkurruesi me afatin më të shkurtër (kur afati është kriter konkurrimi). Në çdo rast, kur kriteret e vlerësimit janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 70 pikë. Formula me të cilën do të llogariten pikët e konkurruesve pasardhës është: $P_i = V_{min} \times P_{max} / V_i$ ku:."

Në shkronjën b "Pjesa e veçantë" fjalia e parë e paragrafit të parë të pikës 2 "Për mallrat" ndryshon si më poshtë vijon:

"Mënyra e livrimit të mallit do të jetë sipas kriterëve të vendosura nga enti prokurues në dokumentet e tenderit."

KAPITULLI IV

Titulli i këtij kapitulli ndryshon si më poshtë vijon:

"Komisioni i vlerësimit të ofertave dhe njësia e prokurimit (hartuesit e dokumenteve të tenderit)".

Paragrafi i dytë ndryshon si më poshtë vijon:

"Njësia e prokurimit (ose hartuesit e dokumenteve të tenderit) përbëhet nga jo më pak se 2 specialistë të fushës së prokurimit dhe një jurist".

Paragrafi i tretë ndryshon si më poshtë vijon:

"Njësia e prokurimit (hartuesit e dokumenteve të tenderit), së bashku me komisionin e vlerësimit të ofertave, të përcaktuar në urdhrin e prokurimit, harton dokumentet e tenderit, sipas detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim".

Paragrafi i shtatë ndryshon si më poshtë vijon:

"Njësia e prokurimit (hartuesit e dokumenteve të tenderit) ka përgjegjësi për shpalljen e njoftimeve ose shpërndarjen e ftesave për ofertë, dërgimin për botim në afat të ftesës për ofertë në buletin e prokurimeve publike, sigurimin e materialeve për plotësimin e dokumentacioneve të tenderit (si hartat, detyrat e projektimit, projektet, preventivat, kushtet teknike, standardet etj.) përgatitjen e dokumenteve të tenderit me formularët përkatës dhe zbatimin e afateve, sipas rregullave të prokurimit publik, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe sipas këtij udhëzimi, llogaritjen e çmimit me të cilin do t'u shiten dokumentet e tenderit kandidatëve (duke u bazuar në nenin 27 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik") dhe dorëzimin e këtyre dokumenteve kandidatëve që dëshirojnë të marrin pjesë në tender".

Fjalja e parë e paragrafit të dhjetë ndryshon si më poshtë vijon:

"Gjatë përgatitjes së ofertave nga kandidatët, njësia e prokurimit ka për detyrë sqarimin e kandidatëve për çdo paqartësi, që mund të kenë gjatë hartimit të ofertave për dokumentacionin e marrë nga enti prokurues, deri në çastin e hapjes së ofertave".

Paragrafi i tetëmbëdhjetë ndryshon si më poshtë vijon:

"Ofertat tekniko-ekonomike duhet të hapen menjëherë pas kualifikimit të ofertuesve. Ofertuesit, të cilët kanë plotësuar kërkesat për kualifikim, vlerësohen të kualifikuar, me përjashtim të rasteve të përmendura në pikat 6 e 7 të nenit 12 të ligjit nr. 7971, datë 6.7.1995 "Për prokurimin publik".

Paragrafi nëntëmbëdhjetë ndryshon si më poshtë vijon:

"Komisioni i vlerësimit të ofertave, pasi ka deklaruar ofertuesin e skualifikuar, për shkak të mosplotësimit të kërkesave për kualifikim, hap ofertat tekniko-ekonomike dhe lexon, me zë të lartë, këto oferta, me të gjithë treguesit e vlerësimit".

Pas paragrafit njëzet e tre shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Në rast se pas vlerësimit të ofertave tekniko-ekonomike, rezultojnë oferta të barabarta, atëherë kur oferta fituese nuk është zgjedhur me mirëkuptim kandidati do të përcaktohet nga shorti i hedhur ndërmjet ofertuesve që kanë paraqitur oferta të barabarta".

Paragrafi njëzet e gjashtë ndryshon si më poshtë vijon:

"Ajo ka për detyrë të mbajë dhe të nënshkruajë të gjitha procesverbalet e punës së komisionit, të cilat, detyrimsht, duhet të jenë të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, të mbledhë dhe të organizojë në një dosje të gjithë dokumentacionin e tenderit (që nga urdhri i prokurimit, njoftimet etj., deri te vendimi i shpalljes së fituesit) dhe, në përfundimin e prokurimit, të dorëzojë dosjen në arkivin e entit prokurues, ku ruhet sipas rregullave të prokurimit publik, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave".

Paragrafi njëzet e shtatë ndryshon si më poshtë vijon:

"Kryetari i komisionit të vlerësimit të ofertave organizon mbarëvajtjen e punës së komisionit gjatë procedurës së prokurimit deri në klasifikimin përfundimtar të ofertave".

KAPITULLI V

Titulli i këtij kapitulli ndryshon si më poshtë vijon:

"Ankimi administrativ".

Paragrafi i parë ndryshon si më poshtë vijon:
"Ofertuesit, që nuk janë dakord me vendimin e entit prokurues dhe që duan të dinë shkaqet e mospranimit të ofertës së tyre, kanë të drejtë të ankohen pranë entit prokurues, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit zyrtar."

KAPITULLI VI

Paragrafi i parë ndryshon si më poshtë vijon:
"Enti prokurues harton një raport përmbledhës sipas pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", ku pasqyrohen të gjitha ankesat, nëse ka, përgjigjet përkatëse dhe i dërgon në organin qendror apo vendor, i cili vë në dispozicion fondin, ose në Agjencinë e Prokurimit Publik, në përputhje me rregullat e prokurimit publik, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave."

Paragrafi i dytë ndryshon si më poshtë vijon:
"Titullari i organit, që vë në dispozicion fondin, apo Agjencia e Prokurimit Publik, në bazë të raportit dhe të ankesave të mundshme, të dërguara nga enti prokurues, gjykon nëse është e nevojshme të kërkohet shqyrtimi i plotë i dokumentacionit të tenderit; në rast të kundërt, ai miraton klasifikimin e ofertave dhe urdhëron veprimet e mëtejshme."

Paragrafi i tretë ndryshon si më poshtë vijon:
"Pas shqyrtimit të dokumentacionit të kërkuar, organi qendror apo vendor, jo më vonë se 20 ditë, apo Agjencia e Prokurimit Publik, jo më vonë se 30 ditë nga marrja e këtij dokumentacioni, duhet të japin miratimin a masa korrigjuese, nëse ka."

Paragrafi i katërt ndryshon si më poshtë vijon:
"Vetëm pas miratimit të organit që vë në dispozicion fondin apo Agjencisë së Prokurimit Publik, enti prokurues ka të drejtë të shpallë fituesin dhe të lidhë kontratën për objektin e prokuruar."

Paragrafi i pestë ndryshon si më poshtë vijon:
"Çdo shpallje fituesi ose lidhje kontrate, përpara miratimit, me shkrim, të organit që vë në dispozicion fondin apo Agjencisë së Prokurimit Publik, është e pavlefshme."

Paragrafi i gjashtë ndryshon si më poshtë vijon:
"Ofertuesi, që nuk është dakord me përgjigjen e entit prokurues, ka të drejtë të ankohet sipas pikës 3 të nenit 44 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik."

Paragrafi i shtatë ndryshon si më poshtë vijon:
"Titullari i entit prokurues, pas miratimit nga organi qendror apo vendor, apo Agjencia e Prokurimit Publik njofton pjesëmarrësin, i cili shpallet fitues, përpara përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës, sipas formularit të dhënë në dokumentet e tenderit."

Paragrafi i nëntë ndryshon si më poshtë vijon:
"Në rast se organi qendror apo vendor, i cili vë në dispozicion fondin apo Agjencia e Prokurimit Publik, e kthen për rivlerësim në entin prokurues klasifikimin e ofertave, atëherë periudha e vlefshmërisë së ofertës mund të shtyhet dhe për këtë njofton me shkrim të gjithë kandidatët e kualifikuar."

KAPITULLI VII

Në nënkapitullin "Bashkimi i përkohshëm i shoqërive", paragrafi i parë ndryshon si më poshtë vijon:

"- të ketë një kontratë të noterizuar, ndërmjet shoqërive, ku të saktësohen punimet që do të kryejë secila shoqëri dhe mënyra se si do të ndahet fitimi për këtë objekt prokurimi."

Paragrafi i tretë i këtij nënkapitulli ndryshon si më poshtë vijon:

"- bashkimi i shoqërive të jetë kryer përpara ditës së hapjes së ofertave."

Pas nënkapitullit "Bashkimi i përkohshëm i shoqërive" shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"- secila shoqëri të paraqesë dokumentacionin ligjor dhe administrativ përkatës, sipas kërkesave të vendosura në dokumentet e tenderit."

Nënkapitulli "Përsëritja e tenderit" ndryshon si më poshtë vijon:

"Procedurat që ndiqen në rast të mossigurimit të konkurrencës

Procedurat e prokurimit do të përsëriten për procedurën "Tender i hapur" kur:

- paraqitet vetëm një ofertë.
Procedurat e prokurimit do të përsëriten për procedurat "Tender i kufizuar" dhe "Kërkesë për kuotim" kur:

- paraqitet vetëm një ofertë;
- ofertat nuk i plotësojnë kërkesat për kualifikim dhe në garë mbeten më pak se tre ofertues;
- ofertat nuk plotësojnë specifikimet tekniko-ekonomike dhe në garë mbeten më pak se tre ofertues.

Në këtë rast, enti prokurues duhet të nxjerrë shkaqet e këtij refuzimi, të rishikojë dokumentet e tenderit dhe të ribëjë procedurat e prokurimit.

Në procedurat e "Tender i kufizuar" dhe "Kërkesë për kuotim" duhet të rishikohet edhe lista e shoqërive të ftuara në konkurim.

Kur enti prokurues, edhe pas ribërjes së procedurave "Tender i kufizuar" dhe "Kërkesë për kuotim", vëren mungesë të konkurrencës, kërkon miratim për vazhdimin e procedurës me më pak se tre oferta në Agjencinë e Prokurimit Publik, në mbështetje të shkronjës "d" të nenit 36 dhe të pikës 1 të nenit 40 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik".

Pas nënkapitullit "Përsëritja e tenderit", shtohet nënkapitulli "Shtyrja e procedurës së prokurimit", me këtë përmbajtje:

"Shtyrja e procedurës së prokurimit

Shtyrja e procedurave të prokurimit nga enti prokurues për shkaqe objektive duhet të shoqërohet me procesverbalin përkatës, të nënshkruar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe të njësisë së prokurimit. Për këtë shtyrje të datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të njoftohen të gjithë kandidatët, të cilët kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe të dokumentohet ky njoftim."

Dokumentet standarde të tenderit, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi, do të vazhdojnë të jenë në fuqi deri në çastin e hartimit nga Agjencia e Prokurimit Publik të dokumenteve të tjera standarde.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M **Nr. 103, datë 23.5.2002**

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Kristofor Peçi	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Petrit Ploçi	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““

më datë 23.5.2002, mori në shqyrtim paraprak kërkesën me nr.114 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: Fatos Hamiti

O B J E K T I: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.173, datë 3.5.2002 të Këshillit të Ministrave “Për lirim dhe emërim në detyrë”.

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, pasi shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi Fatos Hamiti ka qenë Prefekt në Prefekturën e Vlorës dhe me vendimin nr.173, datë

3.5.2002, Këshilli i Ministrave e ka shkarkuar nga detyra. Ndaj këtij vendimi ai është ankuar në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të tij.

Kolegji vëren se shqyrtimi i largimit nga detyra e kërkuar nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të nenit 115 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese shqyrton ankesat e organeve të zgjedhura drejtpërdrejt të njësisë së qeverisjes vendore kur ato shpërndahen ose shkarkohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Prefekti nuk hyn në kategorinë e këtyre organeve. Ai, në bazë të nenit 114 të Kushtetutës, është përfaqësues i Këshillit të Ministrave në qarkun përkatës e jo organ i zgjedhur drejtpërdrejt i qeverisjes vendore.

Në këto kushte, kërkesa nuk mund të pranohet për të kaluar në seancë plenare për shkak të mungesës së kompetencës.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/3 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes në seancë plenare.

V E N D I M Nr. 104, datë 24.5.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 02.04.2002, 11.04.2002 dhe 18.04.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.70 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: LILIANA RULI

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. PROKURORIA PRANE GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË, në mungesë.
2. SHPËTIM IDRIZI, përfaqësuar nga avokat Maksim Haxhia.
3. NAZIM BERISHA, përfaqësuar nga avokat Shefqet Dizdari.
4. FATMIR RULI, përfaqësuar nga avokat Maksim Haxhia.
5. LEMAN, ALTINA E HELONA RULI, në mungesë.
6. MIMOZA PASHKO, në mungesë.
7. ÇLIRIM ÇOMO, në mungesë.

O B J E K T I: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit të ndërmjetëm nr.3447 Akti, datë 12.6.1998 të Gjykatës së Rrethit të Tiranës; i vendimeve nr.1292, datë 17.11.1999 të Gjykatës së Apelit të Tiranës; nr.1208, datë 12.11.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) dhe nr.L-2, datë 22.10.2001 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të

Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 142/1 të Kushtetutës.

Kërkuesja ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të mësipërme:

- Vendimi i gjykatës së rrethit për pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit nr.1845, datë 26.8.1997 të Gjykatës së Apelit të Tiranës, është në kundërshtim me ligjin procedural e atë material sepse ajo jo vetëm nuk ka qenë avokate e palës së paditur, por edhe se qenia avokate në kuptim të nenit 494/a të Kodit të Procedurës Civile, nuk është rrethanë e re, por rrethanë e ditur.

- Vendimi i gjykatës së apelit vjen në kundërshtim me parimet e rregullat e Kodit të Procedurës Civile, sepse është shprehur për probleme të pangritura në ankim dhe se e ka vënë kërkuesen në mënyrë të detyrueshme në pozitën procedurale të paditëses.

- Kolegji Civil (Dhoma e Këshillimit) dhe Kolegjit Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara janë shprehur se nuk janë ngritur shkaqe ligjore për rishikim megjithëse janë ngritur shkaqe të tilla.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, kërkuesen e përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit të Tiranës, (Dhoma e Këshillimit), me vendimin e ndërmjetëm datë 12.6.1998, pranoi kërkesën e subjektit të interesuar Shpëtim Idrizi për rishikimin e vendimit nr.1845, datë 26.8.1997 të Gjykatës së Apelit të Tiranës; ndërsa me vendimin nr.1154, datë 14.4.1999, pushoi gjykimin e çështjes me objekt rishikimin e vendimit të mësipërm për mosparaqitje në gjykim të vetë kërkuesit. Mbi ankimin e këtij të fundit, gjykata e apelit, me vendimin nr.1292, datë 17.11.1999, ka vendosur prishjen e vendimit nr.1154, datë 14.4.1999 të gjykatës së rrethit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit, ka ushtruar rekurs kërkuesja Liliana Ruli, por Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) me vendimin nr.1208, datë 22.11.2000 ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk janë shkaqet e parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile për kalimin e çështjes për gjykim në seancë.

Kërkuesja ka ushtruar rekurs në Kolegjin Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë si ndaj vendimeve të gjykatës së apelit e të kolegjit civil, ashtu edhe ndaj vendimit të ndërmjetëm të gjykatës së rrethit për kalimin e çështjes për shqyrtim, por ai kolegji nuk e ka pranuar rekursin me arsyetimin se nuk janë shkaqet e parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile.

Nga vendimet e mësipërme rezulton se çështja është në juridiksionin gjyqësor, sepse duhet të vazhdojë gjykimi i çështjes në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, pra nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese e ligjore të kërkueses Liliana Ruli. Si rrjedhojë, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente për shqyrtimin e kësaj kërkeje.

Gjykata e rrethit, fillimisht, e ka shqyrtuar kërkesën për rishikim në Dhomën e Këshillimit dhe e ka kaluar çështjen për gjykim sipas nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas asaj gjykate, kërkesa ka plotësuar shkakun e parashikuar në nenin 494/a të Kodit të Procedurës Civile për rishikim sepse kanë dalë rrethana të reja, e pikërisht qenia avokate e kërkueses dhe veprimtaria tregtare e saj me palën e paditur. Po sipas kësaj gjykate, veprimtaria tregtare e kërkueses vjen në kundërshtim me ligjin nr.7877, datë 31.5.1994 “Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë”.

Vendimi i Dhomës së Këshillimit të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, për pranimin e kërkesës për rishikim dhe kalimin e çështjes për gjykim, është një vendim i ndërmjetëm i marrë pas shqyrtimit paraprak të kërkesës, pa praninë e palëve. Rrethanat apo provat e reja në kuptim të nenit 494/a të Kodit të Procedurës Civile do të vihen në diskutim e do të vendosen në gjykimin e çështjes me pjesëmarrjen e palëve, pavarësisht nga vendimi i Dhomës së Këshillimit. Në përfundim gjykata, do të shprehet për refuzimin e kërkesës ose për pranimin e saj e prishjen tërësisht apo pjesërisht të vendimit objekt

rishikimi.

Duke qëndruar çështja si më sipër, nëse gjykatat rrëzojnë kërkesën e subjektit të interesuar Shpëtim Idrizi, pretendimet e kërkuarës mund të gjejnë zgjidhje në ato gjykata, pa qenë nevoja t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Vetëm nëse kërkesa do të pranohet nga ato gjykata dhe vendimi objekt rishikimi do të shfuqizohet, kërkuarja mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese kur janë elementet e një procesi jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f të Kushtetutës si, dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M Nr. 106, datë 27.5.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Tefta Zaka	Anëtare e “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 20.12.2001, 17.1.2002 dhe 18.2.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.202/8 Akti që i përket:

K E R K U E S: LLAMBI KAÇANI, përfaqësuar nga avokat Petraq Çurri, me deklaram.
SUBJEKTE TE INTERESUARA:

1. LLAZAR KAÇANI, në mungesë, me shpallje.
2. KALIOPI KAÇANI, në mungesë, me shpallje.
3. ANDREA KAÇANI, në mungesë, me shpallje.
4. KRISTINA DUKA, përfaqësuar nga avokat Petraq Çurri, me deklaram.

O B J E K T I: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.1009, datë 9.11.1999 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 43, 131/f të Kushtetutës; neni 619 i Kodit të Procedurës Civile.

Për shfuqizimin e vendimit të mësipërm, kërkuarja ka parashtruar këto pretendime:

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shkelur parimin kushtetues, sipas të cilit kushdo ka të

drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë.

- Gjykata ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor, pasi më ka mohuar të drejtën e ankimit në këtë Gjykatë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Tefta Zaka, kërkuesin e përfaqësuesin e tij dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin nr.466, datë 16.3.1998, Gjykata e Rrethit të Vlorës ka vendosur pjestimin midis trashëgimtarëve ligjorë të truallit objekt gjykimi me kufizimet përkatëse.

Kundër këtij vendimi është bërë ankim dhe Gjykata e Apelit të Vlorës, me vendimin nr.629, datë 4.12.1998, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Vlorës lidhur me pjestimin e truallit objekt gjykimi.

Mbi rekursin e kërkuesit Llambi Kaçani, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1009, datë 9.11.1999, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes në këtë Gjykatë me argumentin se rekursi i paraqitur është jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 9 të ligjit nr.7574, datë 24.6.1992 “Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet e Procedurave Penale e Civile”, pasi çështja gjykohet sipas Kodit të Procedurës Civile të shfuqizuar.

Përsa sipër, kërkuesi ka pretenduar se është cenuar e drejta e tij për një proces të rregullt ligjor, sepse i është mohuar e drejta kushtetuese e ankimit në një gjykatë më të lartë, sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kolegji Civil, në vendimin e tij nr.1009, datë 9.11.1999, i referohet dispozitave të Kodit të vjetër të Procedurës Civile, dhe jo nenit 619 të Kodit të ri të Procedurës Civile, sipas të cilit vetëm rekursat kundër vendimeve të gjykatës së apelit, të regjistruara deri në ditën e hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Civile, do të shqyrtohen sipas dispozitave të Kodit të mëparshëm. Ndërsa rekursat e regjistruara pas hyrjes në fuqi të Kodit të Procedurës Civile, do të shqyrtohen sipas dispozitave të këtij Kodi.

Në rastin konkret, rekursi është regjistruar në datën 6.1.1999 dhe Kodi i Procedurës Civile ka hyrë në fuqi në datën 1.6.1996. Ky konstatim ka rëndësi sepse bazuar në Kodin e ri të Procedurës Civile dhe në vendimin unifikues nr.14, datë 16.2.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kërkuesi ishte brenda afateve ligjore të kërkuara për të paraqitur rekursin në Gjykatën e Lartë.

Sipas këtij vendimi, kur gjykimi në apel është bërë në mungesë të palës, vendimi përfundimtar i gjykatës së apelit duhet t’i njoftohet palës në mungesë dhe afati 30 ditor i rekursit llogaritet nga e nesërmja e ditës së njoftimit.

Mohimi i të drejtës së ankimit, i garantuar në nenin 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka sjellë edhe mohimin e të drejtës për t’u gjykuar dhe dëgjuar nga një gjykatë më e lartë dhe nga ushtrimi i një kontrolli gjyqësor më të kualifikuar, elementë këto të domosdoshëm për një proces të rregullt ligjor.

Përsa sipër, duhet patur parasysh edhe parimi i njohur dhe i pranuar se në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.1009, datë 9.11.1999 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr. 109, datë 28.5.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 2.4.2002, 7.5.2002 dhe 10.5.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.69 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: HEKURAN BREGU, përfaqësuar nga avokat Arben Hakani, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

1. DAUT DOSTI
2. AHMET DOSTI, në mungesë
3. ILIRJAN DOSTI, në mungesë.

O B J E K T I: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.8, datë 20.4.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1070, datë 21.10.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Pezullimi i aktit nr.219, datë 25.1.2002 të Zyrës së Përmbarimit Tiranë për ekzekutimin e vendimeve të mësipërme.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe neni 45 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të mësipërme:

- Gjykata e Apelit ka zhvilluar proces të parregullt, sepse nuk ka thirrur dhe dëgjuar personin e tretë, duke shkelur parimin e kontradiktoritetit në gjykim.

- Procesi i parregullt ka sjellë si pasojë edhe shkeljen e ligjit material, sepse pas konstatimit të pavlefshmërisë, palët duhet të ktheheshin në gjendjen e mëparshme, duke u detyruar edhe të paditurit t’i kthenin personit të tretë atë që i kanë marrë.

- Këto shkelje, të ngritura edhe në rekursin drejtuar Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, e bëjnë antikushtetues edhe vendimin e tij, sepse pa të drejtë shprehet se nuk ekzistojnë shkaqe ligjore për pranimin e rekursit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesin e kërkuesit, subjektin e interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Apelit të Tiranës ka gjykuar si gjykatë fakti pas kthimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çështjen civile me palë: Paditës Daut Dosti, të paditur Ilirjan e Ahmet Dosti dhe personi i tretë Hekuran Bregu, me objekt pavlefshmërinë e veprimit juridik të shitjes dhe ka vendosur pranimin e tadisë, duke detyruar personin e tretë t'i kthejë paditësit një banesë të lirë nga çdo barrë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1070, datë 21.10.2001, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit të Tiranës.

Kërkuesi Hekuran Bregu, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pretendon se gjykatat si më sipër kanë zhvilluar proces të parregullt ligjor në drejtimet që përmenden në hyrje të këtij vendimi.

Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa e paraqitur është në përputhje me kriteret e parashikuara në nenin 131/f të Kushtetutës sepse është shkelur e drejta kushtetuese për një proces të rregullt ligjor dhe se kërkuesit i janë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Veprimet procedurale të kryera nga Gjykata e Apelit të Tiranës, të cilat janë miratuar pa të drejtë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, për gjykimin e çështjes pa pjesëmarrjen e personit të tretë, e bëjnë procesin gjyqësor të parregullt dhe vendimet antikushtetuese.

Gjykata e Apelit, e cila e ka gjykuar çështjen në themel si gjykatë fakti, duhej të zbatonte të gjitha rregullat procedurale të gjyimit në shkallë të parë, duke thirrur dhe siguruar pjesëmarrjen e palëve në gjykim. Nga aktet e administruara në dosje rezulton se nga kjo gjykatë janë njoftuar me fletë-thirrje, me adresën përkatëse për t'u paraqitur në gjykim në datën 20.3.2000, paditësi Daut Dosti dhe të paditurit Ahmet e Ilirjan Dosti; kurse fletë-thirrja në emër të personit të tretë Hekuran Bregu nuk ka fare adresë dhe është kthyer me shënimin "adresë e shkurtër".

Nga sa më sipër, del qartë se kërkuesi Hekuran Bregu, me cilësinë e personit të tretë, nuk është njoftuar për të marrë pjesë në gjykim. Në procesverbalin e seancës të datës 20.3.2000, mbajtur në Gjykatën e Apelit të Tiranës, ndër të tjera, thuhet se u thirr dhe nuk u paraqit i padituri dhe personi i tretë dhe shton se nga aktet rezulton se ndodhet jashtë shtetit. Pas kësaj, gjykata e apelit ka nxjerrë shpallje për gjykimin e çështjes në datën 20.4.2000, të cilën e ka zhvilluar pa pjesëmarrjen e kërkuesit.

Në këto rrethana, ishte detyrë e gjykatës së apelit, e cila në zbatim të dispozitave procedurale për njoftimet, duhej të përsëriste thirrjen e kërkuesit me adresë të saktë për të siguruar pjesëmarrjen e tij në gjykim. Ashtu siç ka pretenduar kërkuesi në kërkesë dhe vërtetohet edhe nga njoftimi i bërë nga Gjykata Kushtetuese, kërkuesi Hekuran Bregu ka banuar prej vitesh në apartamentin objekt gjykimi dhe se ai nuk është njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, duke i mohuar kështu një të drejtë themelore, të parashikuar nga neni 42/1 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Mosnjoftimi dhe mospjesëmarrja e kërkuesit në gjykim, i ka privuar atij të drejtën për të parashtruar e argumentuar pretendimet për zgjidhjen e drejtë të çështjes. Vlen të theksohet se në këtë aspekt, e drejta për një proces të rregullt ligjor, nuk do të kishte asnjë kuptim pa siguruar pjesëmarrjen e palëve në gjykim. Kjo është një praktikë tashmë e njohur dhe e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese dhe e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sipas të cilës do të ishte pa vlerë përshkrimi në detaje i garancive procedurale të palëve në proces, në rast se atyre nuk do t'u sigurohej ajo që në fakt bën të mundur respektimin e këtyre të drejtave dhe që është pjesëmarrja në gjykim.

Duke qëndruar çështja si më sipër, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duhej të respektonte kërkesën për një proces të rregullt ligjor. Arsyeimi që ky kolegji bën në vendim se Gjykata e Apelit të Tiranës ka zbatuar drejt ligjin pasi ka dërguar fletë-thirrjen për personin e tretë dhe ka bërë shpalljen, nuk i përgjigjet së vërtetës.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që e ka lënë atë në fuqi, janë rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor dhe duhet të shfuqizohen si antikushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.8, datë 20.4.2000 të Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe nr.1070, datë 21.10.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim Gjykatës së Apelit të Tiranës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M Nr. 110, datë 28.5.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Tefta Zaka	Anëtare e “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Zija Vuci	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 24.12.2001, 31.12.2001 dhe 26.3.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.212/12 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: ALI, LIRI E VJOLLCA CENKO, përfaqësuar nga avokat Vasil Plaku, me deklaram.

SUBJEKTE Të INTERESUARA: MAKSIM LUSHA, përfaqësuar nga avokat Ilir Selenica, me deklaram.

O B J E K T I: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr. 2794, datë 5.10.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranë; nr.330, datë 6.4.2000 të Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe nr.220, datë 19.3.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1 i Kushtetutës.

Për shfuqizimin e këtyre vendimeve, kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe:

Në gjykimin e kësaj çështjeje, të tri gjykatat nuk kanë respektuar kërkesat për një proces të rregullt ligjor.

Kështu, vendimi i gjykatës së rrethit ditën e shpalljes nuk ka qenë i nënshkruar nga njëri prej anëtarëve të trupit gjykues. Kjo gjykatë, ashtu si edhe gjykata e apelit ka gabuar që këtë çështje e ka trajtuar si gjë të gjykuar, gjë që nuk është e vërtetë, pasi në ngritjen e padisë kundër subjektit të interesuar, ata kanë vepruar me cilësinë e pronarit të banesës objekt konflikti, pra jo si në rastin e parë që ata nuk ishin pronarë të saj, kur padia e tyre është rrëzuar me një vendim tjetër të mëparshëm.

Këto shkelje janë lejuar edhe nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i cili e ka mbyllur këtë çështje me rrëzim të rekursit tonë në Dhomën e Këshillimit. Në këtë rast, ai, sipas tyre, duhej ta kalonte çështjen në seancë gjyqësore, në mënyrë që aty të vlerësoheshin shkeljet e sipërpretenduarat.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Zija Vuci, kërkuesit e përfaqësuesin e tyre, përfaqësuesin e

subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në vitin 1996 kërkesit Ali, Liri e Vjollca Cenko kanë kërkuar me padi pavlefshmërinë e dy kontratave të shitjes të lidhura nga djali dhe vëllai i tyre Bashkim Cenko me Ndërmarrjen Komunale Banesa Tiranë, veprime juridike këto të kryera në zbatim të ligjit “Për privatizimin e banesave shtetërore”.

Në bazë të këtyre kontratave, kërkesit janë paraqitur si blerës të banesës 1+1 të ndodhur në Rugën “Irfan Tomini”, ndërsa djali i tyre me bashkëshorten e tij, si blerës të banesës 2+1 të ndodhur në Rugën “21 Dhjetori”.

Kërkesit që në fillim kanë bërë shtesë të objektit të padisë duke kërkuar edhe pavlefshmërinë e kontratës së shitjes, me anën e së cilës këta të fundit i kanë kaluar në pronësi banesën e privatizuar subjektit të interesuar, Maksim Lusha.

Shqyrtimi i kësaj çështjeje ka kaluar në të gjitha shkallët e gjyqimit dhe në vitin 1999 ajo i ka shkuar për gjykim Gjykatës së Apelit të Tiranës, e cila me vendimin nr. 552, datë 14.4.1999 ka vendosur si vijon:

- Konstatimin e pavlefshmërisë së kontratave të privatizimit për të dy banesat e lidhura me Ndërmarrjen Komunale Banesa Tiranë, kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme dhe detyrimin e ndërmarrjes t’u kthejë blerësve shumat e marra nga shitja, duke i llogaritur këto sipas indeksit të ri të çmimeve.

- Rrëzimin e padisë për pjesët e tjera.

Ky vendim nuk është kundërshtuar me rekurs nga kërkesit.

Megjithatë, duke shfrytëzuar pjesën e parë të dispozitivit të këtij vendimi, ata kanë arritur të realizojnë në marrëveshje me Ndërmarrjen Komunale Banesa privatizimin e banesës 2+1 dhe ta regjistrojnë atë në emër të tyre në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sado, që në regjistrat e kësaj zyre, figuron si pronar i saj subjekti i interesuar Maksim Lusha.

Mbi këtë bazë, kërkesit kanë ngritur padi të re me objekt rivendikimin e kësaj prone nga i lartpërmenduri. Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, me vendimin nr. 2794, datë 5.10.1999, ka vendosur përsëri rrëzimin e padisë. Ajo duke iu referuar vendimit të sipërpërmendur të Gjykatës së Apelit të Tiranës ka pranuar se, përderisa me këtë vendim është rrëzuar padia e kërkesve ndaj subjektit të interesuar, kjo do të thotë se ky e mban banesën në fjalë me titull zotërimi e jo me cilësinë e poseduesit të paligjshëm jo pronar dhe për rrjedhojë, prania e kësaj rrethane nuk përlligj ngritjen ndaj tij të padisë së rivendikimit.

Në këtë konkluzion ka arritur edhe Gjykata e Apelit të Tiranës, e cila ka pranuar se në këtë rast çështja përbën gjë të gjykuar dhe prandaj me vendimin nr.330, datë 6.4.2000 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Mbi rekursin që kanë ushtruar kërkesit kundër këtyre vendimeve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.220, datë 19.3.2001, të marrë në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit si të pabazuar në ligj.

Gjykata Kushtetuese, pasi shqyrtoi kërkesën për shfuqizimin si antikushtetues të këtyre vendimeve, çmon se shkaqet e parashtruara në këtë drejtim nga kërkesit nuk janë të bazuara. Këta kanë pretenduar se gjykata e rrethit nuk ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor. Sipas tyre, kjo parregullsi është e lidhur me mosnënshkrimin nga ana e njërit prej gjyqtarëve të çështjes, të vendimit përfundimtar që ka dhënë kjo gjykatë.

Për të vërtetuar këtë pretendim ata kanë paraqitur si provë fotokopjen e këtij vendimi të nënshkruar vetëm nga dy gjyqtarë, por pa shënimin zyrtar se ajo është e njëjtë me origjinalin. Nga ana tjetër, edhe në kërkesën e tyre ankimore drejtuar gjykatës së apelit, ata nuk e kanë ngritur një pretendim të tillë si shkak për prishjen e këtij vendimi.

Në këtë gjendje të provave, kur origjinali i këtij vendimi, i cili ndodhet në dosje, del se është nënshkruar nga i gjithë trupi gjyqësor, Gjykata Kushtetuese çmon se fotokopja e paraqitur nga kërkesit nuk mund të rrëzojë përmbajtjen e këtij akti zyrtar.

Po kështu, i pabazuar është pretendimi tjetër i kërkesve se parregullsia e këtij procesi gjyqësor konsiston edhe në interpretimin e gabuar që i kanë bërë këto gjykata institutit të gjësë së gjykuar.

Në lidhje me këtë problem Gjykata Kushtetuese rithekson se është në kompetencën e këtyre gjykatave interpretimi jo vetëm i ligjit material por edhe atij procedural, si edhe zbatimi i tij në zgjidhjen e çështjes konkrete.

Edhe përsa i përket vendimit të Kolegjit Civil të marrë në Dhomën e Këshillimit kjo Gjykatë nuk gjen elementë të ndonjë procesi jo të rregullt ligjor. Kontrollin e tij ai e ka përqëndruar vetëm në përmbajtjen e rekursit të ushtruar nga kërkuesit pa marrë atributet që i takojnë gjykatës, kur kjo, shqyrton çështjen në seancë gjyqësore.

Në këtë shqyrtim paraprak kolegji ka konstatuar se shkaqet e parashtuara në këtë rekurs dhe të paraqitura nga kërkuesit si shkaqe ligjore, janë ndërtuar mbi bazën e analizës së provave, duke iu bërë atyre një vlerësim të ndryshëm nga ai që kanë bërë dy gjykatat e tjera të zakonshme.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese, çmon se shkaqe të tilla të improvizuara nuk hyjnë në kategorinë e atyre shkaqeve ligjore që e bëjnë të nevojshme kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

K Ë R K E S Ë

Kërkuese: Nafie Matopalaj, e bija e Xhezos, lindur më 1947 në Progonat dhe banuese në qytetin e Tepelenës.

Objekti: Kërkoj të shpallet i zhdukur bashkëshorti im Shyqyri Matopalaj, lindur më 1943, në Zhapokike dhe banues në Tepelenë.

Më 10 qershor 1993 bashkëshorti im është larguar si emigrant në shtetin grek. Që nga ajo kohë nuk kemi asnjë të dhënë për fatin e tij, prandaj kërkoj të shpallet i zhdukur.

KËRKUESE
Nafie Matopalaj

NDREQJE GABIMI

Për arsye teknike në Fletoren 11.2.2002 në faqen 323, neni 11 mungojnë dy pika të cilat janë:

4. Formimi profesional publik dhe jopublik zhvillohet nëpërmjet kurseve të formimit, të riformimit dhe të riaftësimit profesional me kohëzgjatje nën tre vjet.

5. Kohëzgjatja në tipa të tjerë të arsimit dhe formimit profesional rregullohet me udhëzim të ministrit që ka në kompetencë tipin e arsimit dhe formimit profesional.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 1. 6. 2002
Doli nga shtypi më 2. 6. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë